

Komisioni për për mbajtjen e dëgjimeve publike për kornizën afatmesme buxhetore dhe qarkoren buxhetore të komunës së Suharekës për vitin 2027-2029

PROCESVERBAL

MBI MBAJTJEN E DËGJIMIT PUBLIK ME QYTETARË

I mbajtur më datë 21/05/2026, në SHFMU “Gjergj Kastrioti” në fshatin Sallagrazhdë, Komuna e Suharekës.

Ora 19:00

1. Baza Ligjore

Ky dëgjim publik është mbajtur në bazë të:

- Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 124, që garanton pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimarrjen lokale;
- Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Statutit të Komunës së Suharekës;
- Dispozitave tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë organizimin e dëgjimeve publike.

2. Të Pranishmit

Në këtë dëgjim publik morën pjesë përfaqësues të komunës, përfaqësues të fshatit dhe qytetarë të interesuar.

- Përfaqësuesi i Komunës: Anëtarët e Komisionit – Armend Krasniqi, Mensur Selimaj dhe Shqipron Bytyçi (Procesmbajtës)
- Banorë të fshatit Sallagrazhdë, gjithsej pjesmarrës **5 qytetarë**
Meshkuj **5**
Femra **0**

3. Rend Dite

1. Hapja e takimit dhe prezantimi i pjesëmarrësve;

2. Prezantimi i projekteve dhe planifikimeve komunale;
3. Diskutimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve;
4. Pyetje, komente dhe rekomandime nga qytetarët;
5. Përmbyllja e takimit.

4. Përmbledhje e Diskutimeve

Gjatë dëgjimit publik, qytetarët paraqitën kërkesat, shqetësimet dhe propozimet e tyre lidhur me infrastrukturën lokale, rrugët, ndriçimin publik, furnizimin me ujë, kanalizimin, shërbimet komunale, arsimin dhe çështje tjera me interes publik.

Përfaqësuesit e komunës dhanë sqarime lidhur me projektet aktuale dhe planifikimet për periudhën e ardhshme, duke u zotuar që kërkesat e qytetarëve do të shqyrtohen në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore të komunës.

Kërkesat e qytetarëve prezent në këtë Dëgjim Publik:

1. **Isuf Sopaj – qytetar i fshatit Sallagrazhdë**, kërkon ndërhyrjen në sanimin e rrugës “3 Dëshmorët e Tivarit” (Rruga e Savrovës), po ashtu në Lagjen “Ramadani” në rrugën aneks i rrugës “Freskia” – “Fadil Vata”, rrugën “Kurtish Hajdini” (sanimin me zhavor), rrugët fushore “Deli Azemi” tek vendi i quajtur “Rezina”, po ashtu rrugën aneks i rrugës “Gjon Kastrioti” (te ura), rruga tek vendi i quajtur “Jaruga”, rruga aneks i rrugës “9 Maji”, si dhe rrugët fushore të fshatit.
2. **Kolë Baftiaj – qytetar i fshatit Sallagrazhdë**, kërkon rregullimin e rrugës “Nu Xhoni” vendi i quajtur “Xherxhi” Segment gjatësia e përafërt 100 metra.


5. Konkluzionet dhe Rekomandimet

- Të evidentohen kërkesat prioritare të qytetarëve;
- Të shqyrtohet mundësia e përfshirjes së projekteve në planifikimin buxhetor komunal;
- Të vazhdohet organizimi i dëgjimeve publike në të gjitha fshatrat dhe lagjet e komunës;
- Të njoftohen qytetarët për realizimin e rekomandimeve dhe projekteve të planifikuara.

6. Përmbyllja

Takimi përfundoi në ora 19:40. Ky procesverbal u hartua për nevoja administrative dhe evidencë zyrtare të komunës.

Pjesë integrale e këtij procesverbali është po ashtu dhe Lista e Pjesmarrjes, me evidencën e pjesmarrësve.

Hartuesi i Procesverbalit


FISHATI SALLA GRADUATE - 21/05.2026			
	EMRI DHE MBLEMRI	VENDI	NENSHKRIMI
1	Gole Bofij	Sallagorad	Bofij
2	Bopred'kuhoj	Sallagorad	Bofij
3	Jusuf Sopaj	Sallagorad	Bofij
4	Gëzim Dërrima	Sallagorad	Bofij
5	Miqem Bofij	Sallagorad	Bofij
45			
46			
47			
48			
49			
50			
51			
52			
53			